

LORETA VASO
NË IMAGJINATËN TIME...
TREGIME PËR FËMIJË

BOTIMET TOENA

Loreta Vaso

Në imagjinatën time

tregime për fëmijë

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike & kopertina: Redi Greva

Ilustrimet © Redi Greva

ISBN:

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Loreta Vaso “Në imagjinatën time...”

“Ta shohësh botën mes syve të fëmijëve gjen buzëqeshjen që ke humbur, çiltërsinë që ke harruar, magjinë që dikur të ka formësuar në këtë që je sot.

Sikur ta shihnim botën me sytë e fëmijëve kufijtë e së pamundurës, që na rrethojnë, nuk do të ekzistonin më. Bota do të ishte e pafundme, e prekshme, frymëzuese.

Në sytë e tyre do të gjenim dritën, ngjyrat, ylberin. Do të gjenim buzëqeshjen dhe gëzimin, lumturinë në formën më të pastër.”

Loreta Vaso, në këto tregime të shkurtra, na ka dhuruar pikërisht ata sy plot jetë që eksplorojnë çdo gjë dhe që gëzohen nga gjithçka që mësojnë. Na ka treguar atë udhëtim plot ngjyra që nis në familje e zgjerohet në komunitetin ku të vegjlit fillojnë të hedhin hapat e tyre të parë. Mendja e tyre është si një libër që shkruhet ditë pas dite, mbushet me personazhe të reja, me ngjarje e fantazi që nuk kanë kufij. Bota e tyre e përditshme është si një pikturë ku të gjithë kanë mundësinë të ngjyrosin fantazinë me mijëra penelata që më vonë do të jenë pjesë e jetës dhe e pasqyrimit të shpirtit të tyre. Çdo fjalë që mësojnë - konceptet, idetë, lidhin me mijëra neurone që do të komunikojnë me këto ndjesi të formuara në fëmijëri gjatë gjithë rrugëtimit të tyre të mëvonshëm. Në këtë moshë, kur shtrohen rrugët e të ardhmes, gjithsecili prej tyre do të endet në një burim të pashtershëm informacionesh dhe idesh të pafundme dhe çdo zbulim do të sjellë një pyetje e çdo pyetje do të sjellë një zbulim të ri.

Loreta Vaso, ka ndarë me ne jo vetëm disa tregime, por edhe përvojën e saj jetësore si nënë dhe tashmë si gjyshe. Ajo na ka sjellë botën e sotshme të fëmijëve, të vizatuar në mendjen e saj nga historitë e përditshme me nipin. Ka arritur të shohë me anë të syve të tij, të gëzohet nga çdo gjë e re që ai mëson, të hutohet e të buzëqeshë nga çdo pyetje që lind pas një të reje që mëson dhe të kthehet dhe njëherë në fëmijëri, aty ku bota është me ngjyra dhe pa paragjykime. Ajo na tregon realitetin që jetojnë sot, atë realitet ku bota është me mundësi të reja, ku edhe emrat e fëmijëve kanë ndryshuar nga ata me të cilët janë rritur, por historitë mbeten sërish të bukura, sërish ngazëlluese.

Autorja na fton në udhëtimin e tyre, të shokëve dhe prindërve, duke filluar qysh nga lodrat dhe mekanizmat e formimit, nga planetët e miqtë imagjinarë, duke na përqsasur me sfidat dhe tejkalimin e tyre. Ajo na mëson se durimi e dashuria janë çelësi për një fëmijëri të lumtur dhe për këtë rol luan koha, aq e munguar në shoqërinë tonë të sotme. Koha për t’iu përkushtuar familjes, fëmijëve, por edhe mijëra detajeve të vogla që një ditë do të bëjnë ndryshimin. Koha për t’iu mësuar diçka të re, koha për t’u argëtuar me tregimet e tyre plot ngjyra, koha për t’u kthyer edhe njëherë fëmijë pranë tyre, koha për t’iu gëzuar hapave të tyre të parë në jetë. Dhe ndoshta kjo është ajo që vjen si një lajtmotiv i rëndësishëm në këto tregime. Familja është ajo strehëza e parë ku fëmija eksploron, mëson, krijon imagjinatën dhe ndihet i sigurt për të eksploruar. Prindërit janë heronjtë që dinë çdo gjë, i përgjigjen çdo pyetjeje dhe hapin një nga një dyert e dijes për fëmijët e tyre. Janë ajo pjesë e botës ku fëmija do të ndiejë gjithnjë siguri, dashuri e mbështetje. Dhe ata duhet të jenë gjithnjë pjesë e jetës së fëmijëve të tyre. Pjesë e cila nuk mund të zëvendësohet me asgjë. Familja dhe komuniteti, në një rrugëtim të pandashëm, janë baza ku këto qenie të brishta, të formuara për të eksploruar, furnizohen dhe formësohen për t’u bërë të rriturit e së ardhmes e për të ndarë një stafetë, e cila kalon nga brezi në brez.

Sikur të shikonim botën përmes syve të fëmijëve, secili nga ne do të gjente diçka të vetën, të humbur gjatë rrugës, të transformuar nga koha, të fshehur në ndonjë cep të mendjes e të pluhurosor nga harresa. Do të gjente atë gëzimin e plotë që të mbush shpirtin e të nxit fantazinë, që të bën të kujtosh përqafimin e prindërve, përrallat e gjyshes, lojërat me shokët dhe kohët kur ditët ishin të pafundme, e kur mezi prisje të nesërmen për të mësuar diçka të re. Sikur ta shikonim botën me sytë e fëmijëve, do të gjenim atë kohë ku e pamundura ishte e mundur, ku mund të krijonje me mijëra histori me gjithçka që të entuziazmonte, histori që ende janë të fjetura brenda teje dhe presin të zgjohen, pikërisht nga buzëqeshja e një fëmije, nga shkëlqimi i syve të tyre, nga pyetjet që i drejtojnë botës. E ndonëse pyetjet nuk janë gjithmonë të njëjta, ajo ndjesia kur një fëmijë udhëton në imagjinatën e pacunguar nga rregullat e kufizimet, mbetet gjithmonë e njëjtë. Mbetet si forma më e pastër e lumturisë.

Dhe këtë ndjesi na ka sjellë Loreta Vaso në rrugëtimin e imagjinatës së personazheve të saj të vegjël.

Lumturinë që mund të bëhet e prekshme vetëm nëse arrin ta shohësh botën përmes syve të tyre.

Brunilda Zllami

Hyrje


Fjalët e vogëlushëve udhëtojnë nga njëra ditë në tjetrën, nga muaji në muaj dhe nga njëri vit në tjetrin! Përgjatë këtij udhëtimi ato ndryshojnë, nga rrokje që lozin me njëra-tjetrën, plotësohen e bëhen fjalë. Ato shtohen nga dita në ditë, madje vjen një çast kur ndjekin edhe imagjinatën e tyre. Përmes të imagjinuarit, vogëlushët fluturojnë në vendet e bukura dhe takojnë personazhet e tyre.

Por ndonjëherë ndodh të shndërrohen duke e imagjinuar veten edhe si personazh ose si një prej figurave që parapëlqejnë më shumë.

Nëse, ne, të rriturit i ndjekim nga pas duke u lënë hapësirën e nevojshme, sa hapja e krahëve të tyre të vegjël, do të përplasim duart bashkë me ta nga gëzimi.

Kështu ndodh shpeshherë edhe me vogëlushin tonë, aq sa nga njëra ditëlindje në tjetrën kupton se ai jo vetëm ka pasuruar fjalorin me fjalëza të reja, por ato janë shndërruar në varkëza që e shpien atë drejt udhëtimeve imagjinare.

Unë jam Tomasi



Çuf - çuf, çuf - çuf, - dëgjohej
gulçima e lokomotivës që
shfrynte duke ecur mbi shina.

“Si rrotullohen këto
mekanizmat... kur ecën Tomasi!”,
mendonte vogëlushi, krejt i
përqendruar në lëvizjet e tyre. Ai
po vështronte me vëmendje se si
pranë lokomotivës Tomas
qëndruan dy të tjerat. - Diçka po
bisedon ky Tomasi me Tobyn dhe
Percyn, - u dëgjua zëri i tij kur pa
që lokomotivat ishin afruar pranë
njëra-tjetrës.



- O ma, o ba do të bëjmë dhe ne një hekurudhë në shtëpi? - kërceu papritur vogëlushi duke i hedhur sytë sa nga mami te babi.

- Po... të mendohemi, si mund ta bëjmë një të tillë që t'i afrohet hekurudhës në filmin tënd, - iu përgjigj mami e zënë në befasi nga pyetja e të birit.

“Si mund ta sajonin një lloj ‘hekurudhe’ brenda shtëpisë...”, vriste mendjen ajo duke lëvizur sa nga njëra qoshe e shtëpisë, në tjetrën.



- Të mendohemi, o ma, të mendohemi, - tha vogëlushi sikur t'i ftonte diku duke vendosur dorën e vogël në kokë, me gishtin tregues pranë ballit. Të menduarit nuk përfshiu vetëm ata të dy, por edhe babin, që po ndiqte bisedën e tyre.

- Të mendohemi... të mendohemi... - përsëriste Tomasi i vogël dhe të menduarit rrethoi butë dhe ëmbël gjithçka pranë tyre si të ishte një zanë që me shkopin e saj magjik prekte secilin, madje dhe objektet përreth.

Pa e kuptuar, të tre ecnin nëpër shtëpi, herë nga njëri drejtim, herë në tjetrin. Vogëlushi u vinte nga pas duke ndjekur herë mamin, herë babin, sikur edhe ai merrte pjesë në të menduarit e tyre.

Pasi biseduan me njëri-tjetrin, të dy prindërit ia nisën punës. “Çfarë do të bëjnë tani, mami me babin?”, thoshte me vete vogëlushi. - Gordon, pse e more atë shiritin e zi? - pyeti ai të atin me padurim.

- Ky shiriti që ngjitet në dysHEME quhet izolant dhe ne do të formojmë shinat, - i tregoi i ati. Vogëlushi u gëzua aq shumë sa filloi të rendte nëpër shtëpi dhe hajde ta mbaje! - Gordon, - i thirri të atit, - ne do të kalojmë te shinat, çuf - çuf, çaf - çuff, - dhe i vogli filloi të vraponte sa nga njëra qoshe e kuzhinës në tjetrën. - Edhe unë do të ngjis, o ba, - thoshte duke u futur mes prindërve e duke u përpjekur të ngjisë dhe ai shiritin e zi në dysHEME.



Por nuk mbaronte me aq, sepse që nga ai çast, ai jo vetëm do ta quante veten Tomas dhe do të ecte nëpër “shinat imagjinare”, por edhe të atin filloi ta thërriste me emrin Gordon.

- Unë jam Tomasi! - përsëriste ai me zë të lartë, kur të rriturit i drejtoheshin me emrin e tij të vërtetë. - Po, po, jam kthyer në Tomas!


Në filmin e tij të parapëlqyer,
lokomotivat bisedonin si
njerëzit, kështu që vogëlushi i
drejtohej të atit si të ishin dy
lokomotiva. Çdo ditë, kur ai
kthehej nga puna, Tomasi
vraponte duke e thirrur:
- Gordon, Gordon, eja pas meje!
Çuf - çufet ishin bërë aq të
zakonshme, sa edhe emrat
Tomas dhe Gordon. Një ditë
vogëlushi iu kthye mamit:
- Po mekanizmat e Tomasit,
o ma, si janë?

Ai kërkonte të dinte më shumë, donte t'i shihte si lëviznin ato pjesët e hekurta që bënin aq zhurmë në filmin e lokomotivave. Dhe nuk dorëzohej, kërkonte të dinte më shumë, aq sa prindërit e tij e kuptuan se nuk mjaftonte “hekurudha që kishin ndërtuar në shtëpi”.

- Do të shkojmë të shohim trenin sot, Tomas? - i drejtua i ati të birit një të shtunë.

- Po, po, po, - u gëzua vogëlushi, - te Tomasi, te Tomasi!

Të nesërmen, ata të tre, bashkë me gjyshin u nisën për të parë trenin e vërtetë. Por atë nuk e gjetën as në Tiranë, as në Durrës...



- Ku ndodhet ky Tomasi? - pyeste herë pas here vogëlushi prindërit dhe pasi nuk i mbush mendja nga fjalët e tyre, iu drejtua gjyshit që drejtonte makinën:

- Gjyshi, kur do ta shohim Tomasin e vërtetë?

- Ja, për pak, - ia ktheu ai, - sa të arrijmë në Kashar.

Kaq donte Tomasi dhe filloi të përsëriste me zë të lartë:

- Erdhëm në Kashar! Erdhëm në Kashar!

Eja me gjyshin, - i tha ai, pasi zbritën nga makina, të presim kur të kalojë Tomasi i vërtetë!

Më në fund do të shihnin Tomasin e vërtetë!
Vogëlushi qëndronte mbi platformë, krejt i
përqendruar te lokomotiva që dukej së largu.

- E dëgjon sirenën? - e pyeti babi.

Po vjen Tomasi, Gordon! - ia ktheu vogëlushi i
ngazëllyer. - Erdhi, erdhi! - thërriste ai pa i hequr
sytë nga lokomotiva që po afrohej.

Treni, pasi ngadalësoi shpejtësinë, qëndroi në
stacion. - Mekanizmat që rrotullohen si të Tomasit,
o ba..., - i tha ai të atit teksa vështronte i habitur
pjesët metalike të lëvizshme të lokomotivës.



- Eja shkojmë t'i shohim nga afër, - i tha gjyshi duke e marrë në krahë dhe duke u drejtuar nga lokomotiva. Makinisti me punëtorët e tjerë po përpiqeshin të shkëpusnin lokomotivën nga vagoni, ngjitur me të.

- Sa i madh është ky treniii! - thërriste Tomasi i vogël krejt i habitur.

- Sa të mëdha i paska këto mekanizmat që bëjnë zhurmë! Fjala mekanizmat ishte paksa e vështirë për të, por vogëlushi e shqiptonte të plotë pa ngrënë asnjë shkronjë.

Në platformë ishin vetëm ata të katërt që vështronin veprimet e punonjësve të trenit.


- Po ku janë njerëzit që do të hipin te Tomasi? - i drejtua ai gjyshit,

- ky Tomasi qenka bosh fare!

- Njerëzit... nuk ka njerëz për të hipur... - i përgjigj gjyshi i zënë ngushtë nga pyetja e vogëlushit.

- Sepse nuk kanë ardhur akoma? - vazhdoi ai të pyeste.

Sa herë që nuk bindej për diçka, Tomasi nuk hiqte dorë lehtë nga pyetjet.



- Shiko, - ndërhyri mami, që gjithmonë gjente fjalët e duhura për të sqaruar të birin. - Këtu, treni qëndron për të bërë kontrollin e pajisjeve dhe të mekanizmave e më pas vazhdon rrugën drejt stacionit ku hipin njerëzit.

- Si Tomasi, o Gordon, - thirri i gëzuar vogëlushi sa dëgjoji fjalën “mekanizma”, që e pëlqente shumë. Dukej sikur edhe imagjinata po vraponte e gëzuar si vogëlushi kur “shndërrohej” në Tomas: çaf - çuf, çaf - çuf!

- Largohe mi tani? - e pyeti mami, - pasi edhe treni po niset.

- Po, po... Largohe mi, - iu përgjigj ai pasi e kishte shuar kureshtjen.